



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2510/9 prot.

Datë 08 .11.2023

**V E N D I M**

**Nr. 1143/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.11.2023 me

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-76323-07-28-2023 me objekt “Sistem i menaxhuar i printimit (SMP)”, me fond limit 5,870,000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 10.08.2023 nga autoriteti kontraktor Sh.A Albpetrol.

**Autoriteti Kontraktor:** Sh.A Albpetrol  
Selia Rruga Fier – Patos, km 7, Patos.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK, me NIPT J62426002Q dhe adresë: Kodër Kashar, Autostrada Tiranë Durrës, Km 8, Tiranë.

**Baza Ligjore:** Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe

*funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

1.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

1.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 31.07.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit me “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-76323-07-28-2023, me objekt “Sistem i menaxhuar i printimit (SMP)” me fond limit 5,870,000 (pesë milion e tetëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, nga autoriteti kontraktor, Albpetrol Sh.A

II.2. Në datën 10.08.2023, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3 Në datë 18.08.2023 autoritetit kontraktor, ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

“Infosoft Office” SHPK	3,216,620.24 lekë	Skualifikuar
“In Print” SHPK	5,520,000 lekë	Kualifikuar

“BNT ELECTRONICS” SHPK	5,870,000 lekë	Skualifikuar
“RIKON-AL” SHPK	2,050,000 lekë	Skualifikuar

II.4. Në datë 28.09.2023 autoritetit kontraktor, në zbatim të vendimit Nr. 882/2023, datë 12.09.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik, ka kryer rivlerësim të procedurës së prokurimit në sistemin e prokurimeve elektronike (S.P.E.), duke kualifikuar operatorin ekonomik “Infosoft Office” SHPK.

II.5. Në datë 28.09.2023, autoriteti kontraktor, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike, i ka kërkuar operatorit ekonomik të renditur në vend të parë “Infosoft Office” SHPK, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, të pikës 6 të nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

II.6. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor, rezulton se operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK në datë 29.09.2023 ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar nga autoriteti kontraktor.

II.7. Në datë 03.10.2023, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësim të procedurës së prokurimit duke skualifikuar operatorin ekonomik “Infosoft Office” SHPK.

II.8. Në datën 09.10.2023, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE Njoftim - Fituesi paraparak për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, ku fituese është shpallur oferta e operatorit ekonomik “In Print” SHPK.

Operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK është skualifikuar për arsyet si më poshtë vijon:

*“ Për kriterin ç) të Kriterëve të Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit, ka depozituar OE Infosoft Office ShPK, për ortakun Dobi Management ShPK, nuk ka depozituar ndonjë dokument provues që ai (subjekti juridik Dobi Management ShPK) nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së, kjo në kundërshtim me kriterin e përcaktuar në pikën ç) të Kriterëve të Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit, të DST.*

*Për kriterin 2.3.2 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, ka depozituar: OE Infosoft Office ShPK, për 5 copë Pajisje Multifunkionale bardhë e zi A3/A4 standard - Lexmark MX912de, të paraqitur në deklaratën B, “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)”, të pjesës III të Kriterëve të Përzgjedhjes/Kualifikimit, të shtojcës 9 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, nuk ka depozituar ndonjë katalog provues, kjo në kundërshtim me nenin 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, ku parashikohet që “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike”, nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” të ligjit nr.162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”*

*Për kriterin 2.3.3 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, ka depozituar:*

*OE Infosoft Office SHPK, për pajisjet Ricoh dhe Konica Minolta, të deklaruara në ofertë, nuk ka depozituar ndonjë dokument provues për punonjës të certifikuar nga prodhuesi i pajisjes ose distributori i autorizuar për mirëmbajtjen e pajisjeve të paraqitura në ofertë ose me certifikatë ekuivalente të lëshuar nga institucionet e autorizuar të akredituara nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, kjo në kundërshtim me nenin 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, ku parashikohet që “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike”, nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” të ligjit nr.162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”*

II.9. Në datën 16.10.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2023/3498 dhe me nr. 2510 prot., datë 16.10.2023 e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK., lidhur me skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit objekt ankimi .

II.10 Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 2510/2 Prot., date 17.10.2023, lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK, të cilat kundërshtohen në ankesën me nr. 2510 prot, datë 16.10.2023.

II.11. Në datën 27.10.2023, është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr.2510/3 prot., shkresa e autoritetit kontraktor me nr. 7272/4 prot., datë 25.10.2023, me objekt: “Dërgim vendimi mbi ankesën e OE “Infosoft Office” SHPK, drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik, bashkëngjitur Vendimin e KSHA-së Nr.7272/6 prot., datë 24.10.2023, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues. Referuar Vendimit të KSHA-së rezulton, se autoriteti kontraktor e ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK dhe ka vendosur pranimin pjesërisht të saj.

II.12. Në datën 30.10.2023 Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin nr.1085/2023, ku vendosi:

- 1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-76323-07-28-2023 me objekt “Sistem i menaxhuar i printimit (SMP)”, me fond limit 5,870,000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 10.08.2023 nga autoriteti kontraktor Sh.A Albpetrol.*
- 2. Të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.*
- 3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë*

II.13. Me qëllim vijimin e shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, me anë të shkresës nr.2510/6 prot., datë 31.10.2023, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua Autoritetit Kontraktor, duke i kërkuar informacion si më poshtë: [...] *Sa më sipër, me qëllim vijimin e gjyqimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ju lutem të paraqisni pranë KPP-së, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja dijani e kësaj shkrese, dokumentacionin e plotë të dorëzuar pranë autoritetit tuaj kontraktor, nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK, në mbështetje të pikës 6 të nenit 26 të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar”, sa i takon plotësimin të kritereve të kualifikimit të përcaktuar në shtojcën 8, “Formular i kritereve të përzgjedhjes/kualifikimit”/ 2. Kriteret e Veçanta të kualifikimit/ II, 2.3 Kapaciteti teknik, pika 2.3.2 dhe 2.3.3. Dokumentacionin i sipërpërmendur të paraqitet në original ose në kopje të njësuara me origjinalin.”*

II.14. Në datën 06.11.2023 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 2510/7 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 8169/1 prot., datë 03.11.2023, me objekt: “Dërgim - informacioni”, ku konstatohet, se bashkëlidhur kësaj shkrese është dorëzuar dokumentacioni i paraqitur pranë autoritetit kontraktor nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK.

II.15.Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk ka argumente të paraqitura nga subjekte të interesuara në kuptim të nenit 113, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

II.16. Në datën 03.11.2023, protokolluar pranë KPP me nr.2510/6 prot., operatori ekonomik “In Print” SHPK, si operator ekonomik i interesuar në këtë procedurë prokurimi, ka dorëzuar kundërshtime jo konform nenit 113 të LPP-së.

II.17.Në datën 07.11.2023, protokolluar pranë KPP me nr.2510/8 prot., operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK, ka dorëzuar kundërshtime ndaj vendimit të KSHA-së nr.7272/6 prot. të 24.10.2023.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e

ofertës së tij me arsyen se [...] Për kriterin 2.3.2 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, ka depozituar: OE Infosoft Office ShPK, për 5 copë Pajisje Multifunktionale bardhë e zi A3/A4 standard - Lexmark MX912de, të paraqitur në deklaratën B, “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)”, të pjesës III të Kriterëve të Përzgjedhjes/Kualifikimit, të shtojcës 9 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, nuk ka depozituar ndonjë katalog provues, kjo në kundërshtim me nenin 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, ku parashikohet që “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike”, nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” të ligjit nr.162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1.Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.2. të “Kapacitetit teknik”, të dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit, nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kriterit si më poshtë vijon:

2.3.2.Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog/broshurë/skede teknike, nga firma prodhuese për pajisjet që ofron për këtë objekt prokurimi.

Në Katalogun/broshurën/skedën teknike të shënohen në mënyrë të dukshme lloji i pajisjes së ofruar, së bashku me specifikimet teknike të kërkuara nga AK. (Pjesët specifike të katalogut/broshurës/skedës teknike ku jepen karakteristikat e pajisjeve n.q.s. nuk janë në gjuhën shqipe të perkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen).

Ndërsa në Aneksin 1 të shtojcës 5 “Formulari i specifikimeve teknike“ të dokumenteve të tenderit, ka përcaktuar specifikimet teknike të pajisjeve objekt - prokurimi si më poshtë:

### **ANEKSI 1 – Nevojat dhe specifikimet e pajisjeve të SMP**

#### **3 pajisje -A4/A3 me shpejtesi te mesme me keto specifikime :**

Fotokopje/Printer/Skaner	
Teknologjia	Lazer/Bardh/zi
Shpejtesia jo me e vogel se:	25 faqe/min
Ekrani me diapazon:	7 inch - 10.1 inch
Resolucioni	1200x1200 dpi
Dimensioni E x D x H , jo me i madh se:	590x675x965
Kapaciteti mbajtes i sirtareve, jo me i vogel se:	800 faqe
Kapaciteti ne dalje jo me i vogel se:	300 faqe
Madhesia e letres	A6-A3
Memorja jo me e vogel se:	1 GB
HDD - Hardisk jo me i vogel	250 GB
Aplikacione	Pajisja duhet te mundesoj instalimin e aplikacioneve te ndryshme, duke perfshire dhe aplikacion per monitorim apo menaxhim printimi.

Connection	Ethernet, USB
Mundesi skanimi ne HDD	Pajisja duhet te mundesoje skanimin ne HDD e saj dhe krijimin e folderave te ndryshem per secilin perdorues
Skanimi: SPDF-single pas document feeder (skanimi i njehershem te dy aneve te letres)	Full Netëork color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, Scan to USB, SD CARD) skanimi me SD CARD te kryhet dhe ne adaptor
Shpejtesia e Skaimit SPDF :	120 ipm (simplex) / 240 ipm (duplex)
Mobile printing(aftesi printimi nga celulari)	Apple AirPrint, Google Cloud Print,Mopria
Secure printing	Pajisja duhet te mundesoje encryptimin te hardiskut per ruajtjen e informacionit te printim/skanim/fotokopjim.
Printimin ne te dyja anet (Duplex)	Po
Pajisja te mundesoje skanimin e dokumentave direct ne Dropbox, Sharepoint, icloud, etc.	

### 5 pajisje -A4/3 me shpejtesi te mesme me keto specifikime :

Fotokopje/Printer/Skaner	
Teknologjia	Lazer/Bardh/zi
Shpejtesia jo me e vogel se:	25 faqe/min
Ekrani me diapazon:	7 inch - 10.1 inch
Resolucioni	1200x1200 dpi
Dimensionimi E x D x H , jo me imadh se:	350x495x505
Kapaciteti mbajtes i syrtareve jo me i vogel se:	300 faqe
Kapaciteti ne dalje jo me i vogel se:	100 faqe
Madhesia e letres	A6-A3
Memorja jo me e vogel se:	1 GB
HDD - Hardisk jo me i vogel se:	250 GB
Aplikacione	Pajisja duhet te mundesoje instalimin e aplikacioneve te ndryshme, duke perfshire dhe aplikacion per monitorim apo menaxhim printimi.
Connection	Ethernet, USB
Mundesi skanimi ne HDD	Pajisja duhet te mundesoje skanimin ne HDD e saj dhe krijimin e folderave te ndryshem per secilin perdorues
Skanimi: ARDF	Full Netëork color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, Scan to USB, SD CARD) skanimi me SD CARD te kryhet dhe ne adaptor
Shpejtesia e Skanimit	30 ipm
Mobile printing(aftesi printimi nga celulari)	Apple AirPrint, Google Cloud Print,Mopria
Secure printing	Pajisja duhet te mundesoje encryptimin te hardiskut per ruajtjen e informacionit te printim/skanim/fotokopjim.
Printimin ne te dyja anet (Duplex)	Po
Pajisja te mundesoje skanimin e dokumentave direct ne Dropbox, Sharepoint, icloud, etc.	

**10 pajisje -A4 me shpejtesi te mesme me keto specifikime:**

Fotokopje/Printer/Skaner	
Teknologjia	Lazer/Bardh/zi
Shpejtesia jo me e vogel se:	25 faqe/min
Ekrani me diapazon:	7 inch - 10.1 inch
Resolucioni	1200x1200 dpi
Dimensioni E x D x H , jo me imadh se:	480x445x510
Kapaciteti mbajtes i syrtareve jo me i vogel se:	300 faqe
Kapaciteti ne dalje jo me i vogel se:	200 faqe
Madhesia e letres	A6-A4
Memorja jo me i Vogel:	1 - 2 GB
HDD - Hardisk jo me i vogel se:	250 GB
Aplikacione	Pajisja duhet te mundesoj instalimin e aplikacioneve te ndryshme, duke perfshire dhe aplikacion per monitorim apo menaxhim printimi.
Connection	Ethernet, USB
Mundesi skanimi ne HDD	Pajisja duhet te mundesoj skanimin ne HDD e saj dhe krijimin e folderave te ndryshem per secilin perdorues
Skanimi: SPDF-single pas document feeder (skanimi i njehershem te dy aneve te letres)	Full Netëork color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, Scan to USB, SD CARD) skanimi me SD CARD te kryhet dhe ne adaptor
Shpejtesia e skanimit	40 ipm (simplex) / 80 ipm(duplex)
Mobile printing(aftesi printimi nga celulari)	Apple AirPrint, Google Cloud Print,Mopria
Secure printing	Pajisja duhet te mundesoj encryptimin te hardiskut per ruajtjen e informacionit te printim/skanim/fotokopjim.
Printimin ne te dyja anet (Duplex)	Po
Pajisja te mundesoj skanimin e dokumentave direct ne Dropbox, Sharepoint, icloud, etc.	

**30 pajisje me ngjyra-A4 me keto specifikime**

Fotokopje/Printer/Skaner	
Teknologjia	Lazer/me ngjyra
Shpejtesia jo me e vogel se:	25 faqe/min
Ekrani me diapazon:	7 inch - 10.1 inch
Resolucioni	1200x1200 dpi
Dimensioni E x D x H , jo me imadh se:	500x585x510
Kapaciteti mbajtes i syrtareve jo me i vogel se:	200 faqe



Kapaciteti ne dalje jo me i vogel se:	150 faqe
Madhesia e letres	A6-A4
Memorja jo me e vogel se:	1 GB
HDD - Hardisk jo me i vogel se:	250 GB
Aplikacione	Pajisja duhet te mundesoj instalimin e aplikacioneve te ndryshme, duke perfshire dhe aplikacion per monitorim apo menaxhim printimi.
Connection	Ethernet, USB
Mundesesi skanimi ne HDD	Pajisja duhet te mundesoje skanimin ne HDD e saj dhe krijimin e folderave te ndryshem per secilin perdorues
Skanimi: SPDF-single pas document feeder (skanimi i njehershem te dy aneve te letres)	Full Netëork color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, Scan to USB, SD CARD) skanimi me SD CARD te kryhet dhe ne adaptor
Shpejtesia e skanimit	40 ipm (simplex) / 80 ipm (duplex)
Mobile printing(aftesi printimi nga celulari)	Apple AirPrint, Google Cloud Print, Mopria
Secure printing	Pajisja duhet te mundesoje encryptimin te hardiskut per ruajtjen e informacionit te printim/skanim/fotokopjim.
Printimin ne te dyja anet (Duplex)	Po
Pajisja te mundesoje skanimin e dokumentave direct ne Dropbox, Sharepoint, icloud, etc.	

## **2 pajisje me ngjyra-A4/A3 me keto specifikime**

Fotokopje/Printer/Skaner	
Teknologjia	Lazer/me ngjyra
Shpejtesia jo me e vogel se:	25 faqe/min
Ekrani me diapazon:	7 inch - 10.1 inch
Resolucioni	1200x1200 dpi
Dimensioni E x D x H , jo me imadh se:	590x685x1210
Kapaciteti mbajtes i syrtareve jo me i vogel se:	800 faqe
Kapaciteti ne dalje jo me e vogel se:	300 faqe
Madhesia e letres	A6-A3
Memorja jo me e vogel se:	1 GB
HDD - Hardisk jo me i vogel se:	200 GB
Aplikacione	Pajisja duhet te mundesoj instalimin e aplikacioneve te ndryshme, duke perfshire dhe aplikacion per monitorim apo menaxhim printimi.
Connection	Ethernet, USB
Mundesesi skanimi ne HDD	Pajisja duhet te mundesoje skanimin ne HDD e saj dhe krijimin e folderave te ndryshem per secilin perdorues

Skanimi: SPDF-single pas document feeder (skanimi i njehershëm te dy aneve te letres)	Full Netëork color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, Scan to USB, SD CARD) skanimi me SD CARD te kryhet dhe ne adaptor
Shpejtesia e skanimit	110 ipm (simplex) / 180 ipm (duplex)
Mobile printing(aftesi printimi nga celulari)	Apple AirPrint, Google Cloud Print, Mopria
Secure printing	Pajisja duhet te mundesoje encryptimin te hardiskut per ruajtjen e informacionit te printim/skanim/fotokopjim.
Printimin ne te dyja anet (Duplex)	Po
Pajisja te mundesoje skanimin e dokumentave direct ne Dropbox, Sharepoint, icloud, etc.	

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit ka paraqitur në SPE dokumentacion si më poshtë vijon:

*Formularin Përmbledhës të vetëdeklarimit, ku në pjesën III, “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit në deklaratën sipas gërmës B "Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme", në rubrikën "Makineri e mjete" ka deklaruar si më poshtë:*

- 3 copë Pajisje Multifunkionale bardhë e zi A3/A4, e madhe - Ricoh MP 4054;
- 5 copë Pajisje Multifunkionale bardhë e zi A3/A4 standard - Lexmark MX912de;
- 10 copë Pajisje Multifunkionale bardh e zi A4 - Minolta Bizhub 4050;
- 30 cope Pajisje Multifunkionale me ngjyra A4 - Lexmark CX510de;
- 2 copë Pajisje Multifunkionale me ngjyra A3/A4 e madhe - Ricoh MP C4503..."

*Po ashtu ka dorëzuar dokumentet me emërimin:*

- "Katalog Konica\_Bizhup\_4050" gjithsej 10 (dhjetë) faqe, i cili është i përkthyer dhe i noterizuar;
- "Katalog Lexmark\_CX510de\_e\_re" gjithsej 7 (shtatë) faqe, i cili është i përkthyer dhe i noterizuar;
- "Katalog Lexmark\_MX511dhe\_&\_CX510de\_&\_MX711de\_&\_MX912\_de", gjithsej 22 (njëzet e dy) faqe, i cili është i përkthyer dhe i noterizuar;
- "Katalog\_Ricoh MP C4503", gjithsej 18 (tetëmbëdhjetë) faqe, i cili është i përkthyer dhe i noterizuar;
- "Ricoh MP\_4054" gjithsej 18 (tetëmbëdhjetë) faqe, i noterizuar dhe i përkthyer

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

*“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*

*2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*

*3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.1.4. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

*1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.*

*Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.*

*Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.*

*Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.*

*2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

*3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:*

*a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;*

*b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;*

*c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;*

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

III.1.4. Në nenin 41, “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, pika 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se : 2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.1.4. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të

detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.5. Në rastin konkret, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik do të ofrojë mallrat objekt-prokurimi sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në aneksin nr.1 të shtojcës 5 të dokumenteve të tenderit, vërtetuar kjo nëpërmjet paraqitjes së katalogut nga firma prodhuese ose distributori i autorizuar për pajisjet që ofron. Rezulton, se në përmbushje të kriterit 2.3.2, operatori ekonomik ankimes, përveç deklarimit të bërë në Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, për pajisjet që do të ofrojë, ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik dokumentet me emërtimin:

- *"Katalog Konica\_Bizhup\_4050" gjithsej 10 (dhjetë) faqe, i cili është i përkthyer dhe i noterizuar;*
- *"Katalog Lexmark\_CX510de\_e\_re" gjithsej 7 (shtatë) faqe, i cili është i përkthyer dhe i noterizuar;*
- *"Katalog Lexmark\_MX511dhe\_&\_CX510de\_&\_MX711de\_&\_MX912\_de", gjithsej 22 (njëzetë e dy) faqe, i cili është i përkthyer dhe i noterizuar;*
- *"Katalog Ricoh MP C4503", gjithsej 18 (tetëmbëdhjetë) faqe, i cili është i përkthyer dhe i noterizuar;*
- *"Ricoh MP\_4054" gjithsej 18 (tetëmbëdhjetë) faqe, i noterizuar dhe i përkthyer*

Vlerësimi lidhur me përmbushjen e kriterit 2.3.2 të dokumenteve të tenderit, është bërë nga komisioni i vlerësimit të ofertave në datën 18.08.2023, duke mos u ngritur asnjë pretendim sa i përket plotësimin të këtij kriteri nga ana e operatorit ekonomik "InfoSoft Office" SHPK. Referuar arsyes së skualifikimit të cituar në raport audit nga komisioni i vlerësimit të ofertave, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nuk është momenti procedural për të ngritur pretendime për mosplotësimin e këtij kriteri. Dokumentacioni i dorëzuar në SPE, nga operatori ekonomik ankimes në përmbushje të këtij kriteri, është vlerësuar i plotë dhe i rregullt. Nëse autoriteti kontraktor, kishte pretendime për mosdorëzim nga ana e operatorit ekonomik ankimes si operator i renditur i pari, të të gjithë dokumentacionit të kërkuar, duhet t'i kërkonte operatorit ekonomik të dorëzonte në formë shkresore dokumentacionin e plotë të paraqitur në SPE. Për më tepër që nga ana e operatorit ekonomik ankimes pretendohet se është dorëzuar i plotë dokumentacioni i paraqitur në SPE.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimes qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik "InfoSoft Office" SHPK mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e

ofertës së tij me arsyen se [...] Për kriterin 2.3.3 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, ka depozituar: OE Infosoft Office ShPK, për pajisjet Ricoh dhe Konica Minolta, të deklaruara në ofertë, nuk ka depozituar ndonjë dokument provues për punonjës të certifikuar nga prodhuesi i pajisjes ose distributori i autorizuar për mirëmbajtjen e pajisjeve të paraqitura në ofertë ose me certifikatë ekuivalente të lëshuar nga institucionet e autorizuar të akredituara nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, kjo në kundërshtim me nenin 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, ku parashikohet që “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike”, nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” të ligjit nr.162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se ,

III.2.1.Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.3. të “Kapacitetit teknik”, të dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit, nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kriterit si më poshtë vijon:

2.3.3.Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar nga prodhuesi i pajisjes ose distributori i autorizuar për mirëmbajtjen e pajisjeve që oferton, ose me certifikatë ekuivalente të lëshuar nga institucionet e autorizuar të akredituara nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Për këtë të paraqiten:

- Certifikata përkatëse për mirëmbajtjen e pajisjeve që oferton.
- Listepagesat e shoqërisë për të paktën tre muajt e fundit në të cilat specialistet e siperpermendur duhet të figurojë.

**Shenim:** Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

III.2.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit ka paraqitur në SPE dokumentacion si më poshtë vijon:

Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, të firmosur dhe vulosur prej tij, ku në Pjesa III, pika B, Deklaratë “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)” është plotësuar si vijon: “Punonjës PO, Nëse Po, numri i punonjësve: -93 punonjës, F.B., Teknik instalimesh dhe mirëmbajtjesh; M. K., Teknik instalimesh dhe mirëmbajtjesh

Si operator i renditur i pari, operatori ekonomik ankimes “Infosoft Office” SHPK ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor në përmbushje të kriterit të sipërpërmendur dokumentet e poshtëshënuar:

Për punonjësën F.B. ka paraqitur

- Kontratë individuale pune + Diplomën në Inxhinieri Mekatronike, nga Universiteti Politekniki Tiranës
- Certifikatë nga Infolex Lexmark në gradën e Lexmark X series (të përkthyer dhe noterizuar)
- Listëpagesat e muajve Prill, Maj Qershor 2023

Për punonjësën M.K. ka paraqitur

- Kontratë individuale pune + Diplomën në Informatikë-Anglisht të lëshuar nga Universiteti Aleksandër Xhuvani Durrës.
- Certifikatë nga infolex Lexmark në gradën e Lexmark X series (të përkthyer dhe noterizuar)
- Listëpagesat e muajve Prill, Maj Qershor 2023

III.2.3. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

*Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.*

*Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

III.2.4. Në nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” pika 2 dhe 4, e Vendimit Nr. 285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “...Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. ”...

*4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

- a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
- c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*
- d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.*



III.2.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi

III.2.6. Në rastin konkret, nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues se: *OE Infosoft Office ShPK, për pajisjet Ricoh dhe Konica Minolta, të deklaruara në ofertë, nuk ka depozituar ndonjë dokument provues për punonjës të certifikuar nga prodhuesi i pajisjes ose distributori i autorizuar, Komisioni e gjykon të drejtë vendimin e KVO-së së autoritetit kontraktor. Referuar kriterit 2.3.3 të përcaktuar në dokumentet e tenderit, ky kriter përmbushet me dorëzimin e certifikatave për të paktën 2 punonjës të certifikuar nga prodhuesi i pajisjes ose distributor i autorizuar për mirëmbajtjen e pajisjeve që oferton ose me certifikatë ekuivalente të lëshuar nga institucione të akredituara nga DPA ose nga Organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. KPP konstaton, se në përmbushje të kriterit 2.3.3 të kualifikimit nga ana e operatorit ekonomik ankimues janë dorëzuar dokumentet e përcaktuara në pikën III.2.2. të këtij vendimi. Po ashtu, nga ana e operatorit ekonomik ankimues janë paraqitur edhe katalogët nga firma prodhuese për pajisjet që ofron, katalogë të cilët janë përcaktuar në pikën III.1.2. të këtij vendimi. Referuar sa më sipër, kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.3 të dokumenteve të tenderit vlerësohet i përmbushur me paraqitjen e certifikatave të punonjësve, të lëshuara nga prodhuesi ose distributor i autorizuar për pajisjet e ofruara ose certifikata ekuivalente të lëshuara nga institucionet e autorizuar. Nga verifikimi i bërë i certifikatave të paraqitura për dy punonjësit e deklaruar M.K dhe F.B nga operatori ekonomik ankimues, KPP konstaton, se këto certifikata janë të vlefshme vetëm për pajisjet "Lexmark", ndërsa për pajisjet e tjera objekt - prokurimi "Ricoh" dhe Konica Bizhup, të deklaruara në ofertë, operatori ekonomik nuk ka paraqitur certifikata nga prodhuesi ose distributor i autorizuar, ose certifikatë ekuivalente të lëshuar nga institucione të akredituara. KPP gjykon, se operatori ekonomik ankimues nuk ka argumentuar ekuivalencën e certifikatave të paraqitura për pajisjet Lexmark me certifikatat për pajisjet e deklaruar në ofertë "Ricoh" dhe*

Konica\_Bizhup, ose ekuivalencën me certifikata të lëshuara nga institucionet e autorizuar të akredituara nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

### Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-70915-05-30-2023 me objekt “Sistem i menaxhuar i printimit (SMP)”, me fond limit 5,870,000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 10.08.2023 nga autoriteti kontraktor Sh.A Albpetrol.
2. Autoriteti kontraktor të korrigojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK sipas konstatimeve të bëra në këtë vendim.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaïd Myzyri**

